



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 661/1 Prot

Vlorë, më 16.05.2022

VENDIM  
Nr. 14, datë 15.05.2022

PËR  
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT: DIPLOMË E DYFISHTË  
BACHELOR NË "GJUHËSI E APLIKUAR NË FUSHËN E TURIZMIT"  
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 49, nenit 73, 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 të Statuti të UV- së, si dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar) "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Udhëzimit Nr. 7, datë 31.3.2021 "Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, organizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësjive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë, i ndryshuar", Vendimit të Senatit Akademik nr. 22, datë 13.05.2022. "Për miratimin e programit të ri të studimit: Diplomë e dyfishtë Bachelor në "Gjuhësi e aplikuar në fushën e Turizmit", në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 15.05.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Gjuhë-Letërsisë mbështetur dhe nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, konform vendimeve të departamenteve respektive të tyre, për çeljen e programit të ri, në ciklin e parë të studimeve, të llojit "Double Degree", Bachelor në "Gjuhësi e aplikuar në fushën e Turizmit" i cili do të pajisë studentët me: **Diplomë e dyfishtë në Bachelor në "Gjuhësi e aplikuar në fushën e Turizmit"**.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA



Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele  
Tel. Fax ++355222288

Web site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)